



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 637/j Prot.

Tiranë, më 14.04. 2022

Lënda: Për procedurat e konkurrimit të mësuesve në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2022.

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR _____

ZYRËS VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR _____

Në zbatim të të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, të udhëzimit nr. 12, datë 10.6.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar dhe udhëzimit nr. 12, datë 27.02.2018 “Për organizimin e testimit të informatizuar të kandidatëve për t’u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar, të shkresës së MAS nr.1567/1 datë 05.04.2022 “Për një ndryshim të afateve për procedurat e konkurrimit të mësuesve në portalin “Mësues për Shqipërinë” të merren masat e mëposhtme:

1. Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) publikojnë në faqen e tyre zyrtare, në stendat e njoftimeve publike si dhe në rrjetet e tyre sociale afatet për fillimin e procedurave jo më vonë se **15 ditë para fillimit të aplikimit online**. Njoftimi shoqërohet me detaje rreth procedurës dhe dokumentacionin e kërkuar për tu ngarkuar online sipas përcaktimeve të **shtojcës 1**:
 1. Jetëshkrimi (dorëzohet në momentin e punësimit).
 2. **Kërkesa me shkrim për konkurrim sipas modelit të shtojcës 4, e printuar nga sistemi.**
 3. **Kopje e kartës së identitetit (e detyrueshme për t’u ngarkuar online).**
 4. Raport mjeko-ligjor (i tre muajve të fundit dorëzohet në momentin e punësimit).
 5. Vetëdeklarim për gjendjen gjyqësore, sipas shtojcës 5, të këtij udhëzimi (dorëzohet në momentin e punësimit).
 6. **Vërtetim i qendrës së banimit (i detyrueshëm për t’u ngarkuar online).**
 7. Kopje e librezës së punës (i detyrueshëm për t’u ngarkuar online nëse ka dhe dëshiron të vlerësohet me pikë).
 8. **Kopje e diplomës/ave, vërtetimit/listës së notave të studimeve të larta (cikli i parë dhe cikli i dytë) ose të barasvlershme me këto sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi (i detyrueshëm për t’u ngarkuar online).**
 9. **Kopje e licencës së provimit të shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit, për të gjithë kandidatët që kanë detyrim ligjor ta kryejnë këtë provim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi (i detyrueshëm për t’u ngarkuar online).**
 10. Kopje e dëshmimeve të kualifikimit për kategoritë: “Mësues i kualifikuar”, “Mësues specialist”, “Mësues mjeshtër” (nëse ka për t’u ngarkuar online).

Adresa: Rruga “Aleksandër Moisiu”, Përballë IKV, Tiranë. E-mail: DPAPTiranë@arsimi.gov.al

11. Kopje e certifikatave me kredite të trajnimeve të kryera brenda dhe jashtë vendit. Certifikatat me kredite të trajnimeve të kryera brenda vendit të jenë ofruar nga MAS, institucionet e varësisë ose nga agjencitë e akredituara. (nëse ka për t'u ngarkuar online.)
12. Kopje e dëshmisë së njohjes së gjuhës/ve të huaja (nëse ka, për t'u ngarkuar online).
13. **Deklarim nga kandidati për autorizimin e DRAP-së që të shqyrtojë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura sipas shtojcës 6 të këtij udhëzimi (i detyrueshëm për t'u ngarkuar online).**

Shënim. Dokumentet që ngarkohen në platformën e aplikimit online, janë të skanuara nga origjinali.

2. Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) pranojnë dosjet e kandidatëve të cilët dëshirojnë të ushtrojnë profesionin e mësuesit dhe të marrin pjesë në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2022 nga data 20.05.2022 deri në datën 03.06.2022.
3. Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) pranojnë dosjet e kandidatëve të Arsimit Parashkollor të cilët dëshirojnë të ushtrojnë profesionin e mësuesit dhe të marrin pjesë në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2022 nga data 20.05.2022 deri në datën 03.06.2022.
4. Kandidati që dëshiron të ushtrojë profesionin e mësuesit përfshirë parashkollorin dhe të marrë pjesë në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2022, duhet të regjistrohet online në portalin mesuespershqiperine.al nga data 20.05.2022 deri në datën 03.06.2022. Kandidati ngarkon në platformën e aplikimit online dokumentet për konkurrim. Një kopje të dokumentacionit të ngarkuar online, për efekt të vlerësimit të dosjes e dërgon nëpërmjet shërbimit postar në DRAP-in, ku ka qendrën e banimit, sipas ndarjes territoriale dhe për parashkollorin në ZVAP-in ku ka qendrën e banimit.
5. Kandidati, i cili ka qenë pjesëmarrës në portalin e fundit dhe dëshiron të konkurrojë, duhet të ngarkojë online dosjen për konkurrim, në të kundërt, ai përjashtohet nga konkurrimi. Një kopje të kërkesës për konkurrim, sipas shtojcës 4 të këtij Udhëzimi e printuar vetëm nga sistemi i RASH, kandidati e dorëzon edhe në DRAP-në ku ka qendrën e banimit brenda datës 03.06.2022. Në portal, kandidati zgjedh një nga opsionet:
a) Aplikoj për herë të parë, b) Mbart pikët aktuale (dosje+testim), c) Mbart vetëm pikët e dosjes, d) Mbart vetëm pikët e testimit.
6. DRAP-et dhe ZVAP-et krijojnë Komisionin e Vlerësimit të Dosjeve, i cili administron dhe vlerëson dosjet e kandidatëve, sipas përcaktimeve të udhëzimit nr. 12, datë 10.6.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, të ndryshuar, nga data 06.06.2022 deri në datë 20.06.2022 dhe ndjekin të gjitha procedurat sipas përcaktimeve të udhëzimit nr.12 dhe shkresës nr 1567/1 datë 05.04.2022 “Për një ndryshim të afatave për procedurat e konkurimit të mësuesve në portalin “Mësues për Shqipërinë”.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 1567 Prot.

Tiranë, më 05.4. 2022

Lënda: 1 Për një ndryshim të afateve për procedurat e konkurrimit të mësuesve në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2022.

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
Rruga “Aleksandër Moisiu”, Tiranë

AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
Rruga “Naim Frashëri” Nr. 37, Tiranë

QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE
Blv: “Zhan D’Ark”, Nr.23, Tiranë

QENDRËS NDËRINSTITUCIONALE TË RRJETIT AKADEMIK SHQIPTAR
Rruga e Durrësit, Tiranë

Në zbatim të pikës 25 të nenit 2 dhe të pikës 1 të nenit 60 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, të udhëzimit nr. 12, datë 10.6.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar dhe udhëzimit nr. 12, datë 27.02.2018 “Për organizimin e testimit të informatizuar të kandidatëve për t’u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar, të merren masat për zbatimin e detyrave të mëposhtme:

1. Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) pranojnë dosjet e kandidatëve, të cilët dëshirojnë të ushtrojnë profesionin e mësuesit dhe të marrin pjesë në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2022, nga data 20.05.2022 deri në datën 03.06.2022.
2. Kandidati, që dëshiron të ushtrojë profesionin e mësuesit dhe të marrë pjesë në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2022, duhet të regjistrohet online në portalin *mesues-pershqiperine.al*, nga data 20.05.2022 deri në datën 03.06.2022. Kandidati ngarkon në platformën e aplikimit online dokumentet për konkurrim. Një kopje të dokumentacionit të ngarkuar online, për efekt të vlerësimit të dosjes e dërgon nëpërmjet shërbimit postar në DRAP-in ku ka qendrën e banimit, sipas ndarjes territoriale në aneksin nr.1 të kësaj shkrese.
3. Kandidati, i cili ka qenë pjesëmarrës në portalin e fundit dhe dëshiron të konkurrojë, duhet të ngarkojë online dosjen për konkurrim, në të kundërt, ai përjashtohet nga konkurrimi. Një kopje të kërkesës për konkurrim, sipas shtojcës 4 të këtij Udhëzimi, e printuar vetëm nga

- sistemi i RASH, kandidati e dorëzon edhe në DRAP-në ku ka qendrën e banimit brenda datës 03.06.2022. Në portal, kandidati zgjedh një nga opsionet:
- a) Aplikoj për herë të parë, b) Mbart pikët aktuale (dosje+testim), c) Mbart vetëm pikët e dosjes, d) Mbart vetëm pikët e testimit. Në fazën e dytë, “Testim i informatizuar”, marrin pjesë kandidatët që janë regjistruar online në portalin “Mësues për Shqipërinë” dhe që kanë kaluar me sukses fazën e parë “Vlerësim me dosje”.
4. DRAP-et krijojnë Komisionin e Vlerësimit të Dosjeve, i cili administron dhe vlerëson dosjet e kandidatëve, sipas përcaktimeve të udhëzimit nr. 12, datë 10.6.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, të ndryshuar, nga data 06.06.2022 deri në datë 20.06.2022.
 5. DRAP-et, në përfundim të procedurës së vlerësimit të dosjeve, njoftojnë kandidatët për vlerësimin që kanë marrë brenda datës 24.06.2022.
 6. DRAP-et dërgojnë elektronikisht dhe zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, listat e kandidatëve të kualifikuar, duke përcaktuar për çdo kandidat ZVAP-të ku dëshiron të konkurrojë dhe pikët e dosjes brenda datës 27.06.2022.
 7. Kandidatët kanë të drejtë të ankimojnë për vlerësimin e marrë brenda datës 27.06.2022.
 8. Shqyrtimi i ankesave, hartimi dhe shpallja e listës finale të bëhet brenda datës 04.07.2022.
 9. DRAP përgatit dhe dërgon në DPAP listën e kandidatëve që kanë kërkuar të ruajnë pikët e testimit dhe pikët e dosjes së portalit 2021 brenda datës 06.07.2022.
 10. DPAP dërgon në Qendrën e Shërbimeve Arsimore, elektronikisht dhe zyrtarisht listat e kandidatëve që do të marrin pjesë në testimin e informatizuar brenda datës 11.07.2022.
 11. Qendra e Shërbimeve Arsimore organizon testimin e informatizuar, sipas kalendarit të miratuar dhe të publikuar prej saj, në zbatim të Udhëzimit nr.12, të MASR-së, datë 27.02.2018 “Për organizimin e testimit të informatizuar të kandidatëve për t’u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar.
 12. Qendra e Shërbimeve Arsimore dërgon elektronikisht dhe zyrtarisht në DPAP listat e kandidatëve me pikët e fituara në testimin e informatizuar 2022, 5 ditë pas përfundimit të testimit të informatizuar.
 13. DPAP dërgon elektronikisht dhe zyrtarisht në MAS dhe në Qendrën Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH) listat e kandidatëve me pikët e dosjes dhe pikët e testimit të informatizuar 2021, si dhe pasqyron në portalin “Mësues për Shqipërinë” pikët për secilin kandidat jo më vonë se 5 ditë nga rezultatet e dërguara nga QSHA.
 14. DPAP informon DRAP-et dhe ZVAP-të, lidhur me këtë shkresë dhe procedurat e tjera që duhet të ndjekin, deri në përfundim të procedurave të konkurrimit për ushtrimin e profesionit të mësuesit.

SEKRETARI PËRGJITHSHËM



Aneksi nr.1

Ndarja territoriale

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Rruga “Aleksandër Moisiu”, Tiranë

I. DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS

(Adresa: Lagjja Nr.13, Rruga “Egnatia” Kutia Postare 2001, Durrës)

<u>Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar</u>	<u>Bashkia</u>
Dibër	Dibër
Krujë	Krujë
Kamëz	Kamëz
Tiranë	Tiranë
Durrës	Durrës
Bulqizë	Bulqizë
Mat	Mat
Klos	Klos
Shijak	Shijak
Kavajë	Kavajë
Vorë	Vorë
Rrogozhinë	Rrogozhinë

II. DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LEZHË

(Adresa: Sheshi “Gjergj Kastrioti”, kati 2, godina OKF “Gjergj Lacaj”, Lezhë)

<u>Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar</u>	<u>Bashkia</u>
Has	Has
Tropojë	Tropojë
Mirditë	Mirditë
Malësi e Madhe	Malësi e Madhe
Vau Dejës	VauDejës
Pukë – Fushë Arrëz	Pukë – Fushë Arrëz
Kukës	Kukës
Lezhë	Lezhë
Kurbin	Kurbin
Shkodër	Shkodër

III. DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR KORÇË

(Adresa: Lagjia 18, Rruga "Dhimitër Denasi" 7001, Korçë)

<u>Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar</u>	<u>Bashkia</u>
Dimal	Dimal
Kuçovë	Kuçovë
Cërrik	Cërrik
Belsh	Belsh
Peqin	Peqin
Gramsh	Gramsh
Librazhd	Librazhd
Përrenjas	Përrenjas
Maliq	Maliq
Kolonjë	Kolonjë
Berat	Berat
Korçë - Pustec	Korçë - Pustec
Devoll	Devoll
Pogradec	Pogradec
Elbasan	Elbasan
Skrapar	Skrapar
Poliçan	Poliçan

IV. DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER

(Adresa: Lagjia "Kastriot", Rruga "Leon Rei", Fier)

<u>Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar</u>	<u>Bashkia</u>
Patos	Patos
Roskovec	Roskovec
Divjakë	Divjakë
Mallakastër	Mallakastër
Selenicë	Selenicë
Finiq-Dropull	Finiq-Dropull
Tepelenë - Memaliaj	Tepelenë - Memaliaj
Përmet - Këlcyrë	Përmet - Këlcyrë
Sarandë - Konispol - Delvinë	Sarandë - Konispol - Delvinë
Lushnje	Lushnje
Vlorë - Himarë	Vlorë - Himarë
Fier	Fier
Gjirokastrë - Libohovë	Gjirokastrë - Libohovë